



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.153**

**18 nëntor**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.816, datë 13.10.2010	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin vitin 2010, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.....	8101
Vendim i KM nr.825, datë 13.10.2010	Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi.....	8102
Udhëzim i MF nr.38, datë 15.11.2010	Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr.7, datë 16.6.2003 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	8122
Vendim i ERE nr.77, datë 15.10.2010	Për mosmiratimin e disa shtesave në Kodin e Matjes.....	8124
Vendim i ERE nr.78, datë 22.10.2010	Mbi lidhjen e kontratave të negociuara nga shoqëria “CEZ shpërndarja” sh.a. me shoqëritë “CEZ AS” dhe “EFT AG”.....	8125
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të shtetasve Qirjako Adhamidhi dhe Anastas Adhamidhi.....	8125



**VENDIM**  
**Nr.816, datë 13.10.2010**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR  
PËR MINISTRINË E EKONOMISË TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.10 190, datë 27.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Rishpërndarjen e fondeve në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ndërmjet programeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim” të shtohet fondi prej 14 677 465 (katërbëdhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekësh, i ndarë, përkatësisht, për zërat:

- “Shpenzime korente”, në shumën 11 177 465 (njëmbëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë, i ndarë përkatësisht, për “Shpenzime personeli”, në shumën 5 177 465 (pesë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë dhe shpenzime për “mallra dhe shërbime”, 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë;

- “Investime kapitale të brendshme”, në shumën 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë.

b) Kjo shumë të përballohet nga pakësimet e fondeve në programin “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, përkatësisht:

i) për Qendrën Kombëtare të Aplikimeve Energjetike, në vlerën 8 677 465 (tetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë, në këta zëra:

- “Paga”, në vlerën 3 258 225 (tre milionë e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet e pesë) lekë;

- “Sigurime shoqërore”, në vlerën 1 919 240 (një milion e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet) lekë;

- “Investime kapitale të brendshme”, në vlerën 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë.

ii) për Qendrën Kombëtare të Licencimit, në vlerën 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë, në zërin “Shpenzime korente”.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.825, datë 13.10.2010**

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË MBETJEVE QË LEJOHEN TË IMPORTOHEN PËR  
QËLLIME PËRDORIMI, RICIKLIMI DHE PËRPUNIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 22 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi.
  2. Importimi lejohet duke u bazuar në kodet dhe titujt e mbetjeve që figurojnë në:
    - a) Listën e gjelbër, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;
    - b) Listën B të aneksit IX të Konventës së Bazelit, sipas aneksit 2, bashkëlidhur këtij vendimi;
    - c) Katalogun Shqiptar të Mbetjeve (ato pa yll), sipas vendimit nr.99, datë 18.2.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve”.
  3. Mbetjet që do të lejohet të importohen, duhet të jenë të listuara në tri listat e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi.
  4. Ndalohet importimi i mbetjeve të listave të mësipërme në rastet kur ato përmbajnë mbetje e materiale të rrezikshme, në atë masë që përcaktohen sipas ligjit nr.9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”.
  5. Listat e mbetjeve, të miratuara me këtë vendim, rishikohen dhe plotësohen në përputhje me thellimin e përafritit dhe sipas amendimeve të akteve përkatëse të BE-së, nga të cilat ato janë marrë.
  6. Mbetjet importohen dhe ruhen të ndara sipas llojit, që tregohet në kodin dhe titullin e tyre.
  7. Mbetjet e lejuara për importim, sipas këtij vendimi, ruhen në vende të posaçme dhe në kushte të përshtatshme magazinimi, brenda territorit ku kryhet veprimtaria e miratuar për përdorimin, përpunimin dhe riciklimin e tyre.
  8. Importi bëhet sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr.806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave e procedurave për importimin e mbetjeve me qëllim përdorimi, përpunimi e riciklimi”, duke plotësuar fillimisht formularët e anekseve 3 dhe 4, bashkëlidhur këtij vendimi.
  9. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

ANEKSI 1  
MBETJET E “LISTËS SË GJELBËR”

- GA. Mbetje të metaleve dhe aliazheve të metaleve, në trajte metalike jo të shpërbërë <sup>1</sup>
- GB. Mbetje me përmbajtje metali të dala nga shkrirja, ngurtësimi dhe rafinimi i metaleve
- GC. Mbetje që përmbajnë metale
- GD. Mbetje nga operacionet në miniera: Këto mbetje duhet të jenë në trajtë jo të shpërbërë
- GE. Mbetje qelqi në trajtë jo të shpërbërë
- GF. Mbetje qeramike në trajtë jo të shpërbërë
- GG. Mbetje që përmbajnë kryesisht përbërës inorganikë, të cilët mund të përmbajnë metale dhe materiale organike
- GH. Mbetje plastike të ngurta
- GI. Mbetje të letrës, të kartonit dhe produkteve të letrës
- GJ. Mbetje tekstile
- GL. Mbetje të patrajuara të tapës dhe drurit
- GM. Mbetje të industrisë agro-ushqimore
- GN. Mbetje të krijuara nga regjia, përpunimi dhe përdorimi i lëkurës
- GO. Mbetje, me përbërës kryesisht organikë, të cilët mund të përmbajnë metale dhe materiale inorganike.

**GA. Mbetje të metaleve dhe aliazheve të metaleve, në trajtë metalike jo të shpërbërë**

Mbetjet dhe skrapet e mëposhtme që përmbajnë hekur dhe skrape hekuri dhe çeliku

- GA 040 ex 720410 mbetje dhe kthime të gizës së derdhur
- GA 050 ex 720421 prej çeliku të pandryshkshëm
- GA 060 ex 720429 të tjera
- GA 070 ex 720430 mbetje dhe kthime të gizës dhe çeliku të kallajisur
- GA 080 ex 720441 copa të vogla, ashkla, feta, mbetje, bluajtje, pluhur sharrimi, pluhur lëmimi, mbetje nga zbukurimet dhe stampimet, nëse janë apo jo në tufë
- GA 090 ex 720449 të tjera
- GA 100 ex 720450 copa kallëpi të rishkrirë

Mbetjet dhe skrapet e mëposhtme të metaleve joferrore dhe aliazhet e tyre

- GA 120 ex 7404 00 mbetje dhe kthime të bakrit
- GA 130 ex 7503 00 mbetje dhe kthime të nikelit
- GA 140 ex 7602 00 mbetje dhe kthime të aluminit
- GA 150 ex 7802 00 mbetje dhe kthime të plumbit

---

<sup>1</sup> D.m.th. jo në trajtë pudre, llumi, pluhuri apo në trajtë të ngurtë, por që përmban mbetje të rrezikshme të lëngshme.

GA 160 ex 7902 00	mbetje dhe kthime të zinkut
GA 170 ex 8002 00	mbetje dhe kthime të kallajit
GA 210 ex 8104 20	mbetje dhe kthime të magneziumit
GA 230 ex 8106 00	bismuti dhe artikujt prej tij, përfshirë mbetjet dhe kthimet
GA 280 ex 8111 00	mangani dhe artikujt prej tij

**GB. Mbetje me përmbajtje metali të dala nga shkrirja, ngurtësimi dhe rafinimi i metaleve**

GB 010 ex 2620 11 shufra të forta zinku

**GC. Mbetje të tjera që përmbajnë metale**

GC 030 ex 8908 00 Mbetje ujore dhe struktura të tjera lundruese të prishura

GC 040 Mjete lëvizëse motorike të shkatërruara, që iu janë hequr lëngjet

**GD. Mbetjet nga minierat: këto mbetje të jenë në formë jo të shpërbërë**

GD 070 ex 2811 22 Dyoksid silici në formë të ngurtë duke përjashtuar ato të përdorura në fonderitë

**GE. Mbetje qelqi në trajtë jo të shpërbërë**

GE 010 ex 7001 00 Mbetje dhe skrape qelqi me përjashtim të qelqeve të tubave me rreze katodike dhe qelqe të tjera të aktivizuara

GE 020020 ex 701939 Mbetje të fibrave të qelqit

**GF. Mbetje qeramike në trajtë jo të shpërbërë**

GF 010 Mbetje qeramike të pjekura, përfshirë enët prej qeramike para dhe pas përdorimit

**GG. Mbetje të tjera që përmbajnë kryesisht përbërës inorganikë, të cilët mund të përmbajnë metale dhe materiale organike**

GG 100 Gur gëlqeror prej prodhimit të cianamidit të kalciumit (që ka pH < se 9)

GG 130 Carborundum (karbid silikoni)

**GH. Mbetjet, plastike të ngurta**

Duke përfshirë në mënyrë të pakufizuar si më poshtë:

GH 010 3915 mbetjet, prerjet dhe kthimet, prej plastike

- GH 011 ex 3915 10 – prej polimereve të etilenit
- GH 012 ex 3915 20 – prej polimereve të stirenit
- GH 013 ex 3915 30 – prej polimereve të vinil koridit
- GH 014 ex 3915 90 – prej plastikave të tjera (polimere ose bashkime polimeresh)

#### **GI. Mbetje të letrës, të kartonit dhe produkteve të letrës**

- GI 010 ex 4707 letër apo karton i rikuperueshëm
- GI 011 ex 470710 prej letrës apo kartonit të trashë të pazbardhur apo prej letrës apo kartonit të brimuar
- GI 012 ex 4707 20 prej letrës apo kartonit tjetër të bërë kryesisht prej brumit kimik të zbardhur, jo të ngjyrosur në masë
- GI 013 ex 4707 30 prej letrës apo kartonit tjetër të bërë kryesisht prej brumit mekanik (p.sh.: gazeta, revista dhe materiale të tjera të ngjashme të shtypura)

#### **GJ. Mbetje tekstile**

- GJ 010 ex 5003 Mbetje mëndafshi (përfshirë fshikëzat e mëndafshit të papërshtatshme për t'u mbështjellë në rrotëz, mbetje fijesh dhe fijet e hequra prej pëlhurave)
- GJ 020 ex 5103 Mbetje të leshit apo qimeve të holla apo të ashpra të kafshëve, përfshirë mbetje fijesh, por përjashto fijet e hequra prej pëlhurave)
- GJ 021 ex 5103 10 Mbetje nga krehja e leshit apo prej qimeve të holla të kafshëve
- GJ 023 ex 5103 30 Mbetje të qimeve të ashpra të kafshëve
- GJ 030 ex 5202 Mbetje pambuku (përfshirë mbetje fijesh dhe fije të tërhequra prej pëlhurave)
- GJ 031 ex 5202 10 Mbetje fijesh, përfshirë mbetje filli
- GJ 040 ex 5301 30 Fibra të shkurtra ose të thyera dhe mbeturina liri
- GJ 050 ex 5302 90 Të tjera
- GJ 060 ex 5303 90 Të tjera
- GJ 080 ex 5305 Litar, push dhe mbetje (përfshirë mbetje nga fijet dhe gjysmë-produkte ose produkte tekstile të rikthyera) prej arrës së kokosit  
Litar, push dhe mbetje (përfshirë mbetje nga fijet dhe gjysmë-produkte ose produkte tekstile të rikthyera) prej abaca (kërpi Manila)
- GJ 100 ex 5305 99 Të tjera tekstile vegjetale, të paspecifikuara ose të përfshira diku tjetër

GJ 110 ex 5505	Mbetje (përfshirë mbetje të krehjes, mbetje fijesh dhe fije të hequra prej pëlhurave) prej fibrave të bëra nga njerëzit
GJ 011 ex 5505 10	Prej fibrave sintetike
GJ 012 ex 5505 20	Prej fibrave artificiale
GJ 120 ex 6309 00	Veshje të përdorura dhe artikuj të tjerë veshjeje
GJ 130 ex 6310	Lecka, spango, korda, litarë dhe kabëll të mbetura dhe artikuj të dalë jashtë përdorimit prej spangoje, korde, litari apo kabllloje, prej materiali tekstili
GJ 131 ex 6310 10	Të përzgjedhura
GJ 132 ex 6310 90	Të tjera

**GL. Mbetje të patrajuara të tapës dhe drurit**

GL 010 ex 4401 30 Tallash dhe mbetje dhe kthime të drurit, nëse janë apo jo të aglomeruara në kërcunj, briketa, peleta apo forma të tjera të ngjashme

GL 020 ex 4501 90 Të tjera

**GO. Mbetje me përbërës kryesisht organikë, të cilët mund të përmbajnë metale dhe materiale inorganike**

GO 010 ex 0501 00 Flokët e njerëzve, të papunuara, nëse janë apo jo të lara apo të pastruara, mbetje të flokëve të njeriut



ANEKSI 2  
LISTA B E KONVENTËS SË BAZELIT

- B1 Mbetje metalike dhe mbetje me përmbajtje metali
- B2 Mbetje që përmbajnë kryesisht përbërës inorganikë, të cilët mund të përmbajnë metale dhe materiale organike
- B3 Mbetje që përmbajnë kryesisht përbërës organikë, që mund të përmbajnë metale dhe materiale inorganike
- B4 Mbetje që mund të përmbajnë edhe përbërës organikë edhe inorganikë

B1 Mbetjet metalike dhe mbetje me përmbajtje metali ( OK)

B1010 Mbetje metali dhe amalgame metalesh në trajtë metalike jo të shpërbërë:

- Metalet e çmuara (ari, argjendi, grupi i platinit, por jo merkuri)
- Skrape të hekurit dhe çelikut
- Skrape të bakrit
- Skrape të nikelit
- Skrape të aluminit
- Skrape të zinkut
- Skrape të kallajit
- Skrape të tungstenit
- Skrape të molibdenit
- Skrape të tantalumit
- Skrape të magnezit
- Skrape të kobaltit
- Skrape të bismutit
- Skrape të titanit
- Skrape të zirkonit
- Skrape të manganit
- Skrape të germaniumit
- Skrape të vanadiumit
- Skrape të hafniumit, indiumit, niobiumit, rheniumit dhe galiumit
- Skrape të toriumit
- Skrape të dherave të rralla
- Skrape të kromit

B1020 Skrape të metaleve të pastra, të pakontaminuara, përfshi amalgamet, në formë masive përfundimtare (fletë, të sheshtë, traverse shufër etj.) prej:

- Skrap antimoni
- Skrap beriliumi
- Skrap kadiumi
- Skrap plumbi (përfshijë bateritë me plumb-acid)
- Skrap seleniumi
- Skrap teluriumi

B1030 Metale refraktare që përmbajnë mbetje

B1031 Mbetje metalesh dhe aliazesh metalesh me përmbajtje molibden, tungsten, titanium, niobium dhe renium në trajtë metalike të grimcuar (pluhur metali)

B1040 Grumbull skrapesh prej prodhimit të energjisë elektrike, jo të kontaminuara me vaj lubrifikant, PCB ose PCT në një masë që t'i bëjë ata të rrezikshëm

B1050 Përzierje metalesh jo me përmbajtje hekuri, skrape me fraksione të rënda

- B1060 Mbetje seleniumi dhe teluriumi në trajtë metalike, si dhe në trajtë pluhuri
- B1070 Mbetje prej bakri dhe aliazhe bakri në trajtë të shpërbërë
- B1080 Hi zinku dhe mbetje përfshi mbetje të aliazheve të zinkut në formë të shpërbërë
- B1090 Bateri të përdorura, sipas një specifikimi të caktuar, përjashtuar ato me plumb, kadmium ose merkur
- B1100 Mbetje me përmbajtje metali që gjenerohen prej shkrirjes dhe rafinimit të metaleve:
- Zink i rëndë
  - Zgjyra me përmbajtje zinku:
    - zgjyra e sipërme e pllakave galvanizuese të zinkut (>90% Zn)
    - zgjyra e poshtme e pllakave galvanizuese të zinkut (>92% Zn)
    - zgjyra e ngjyresve prej zinku (>85% Zn)
    - zgjyra nga furrat e galvanizimit (>92% Zn)
  - suspensione prej zinku
  - Suspensione të aluminit përjashtuar zgjyrën e kripës
  - Zgjyra, nga përpunimi i bakrit për përpunim të mëtejshëm ose rafinim, që nuk përmban arsenik, plumb apo kadmium në masa të tilla që të manifestojnë karakteristikat e mbetjeve të rrezikshme
  - Mbetje prej veshjeve refraktare, përfshirë ato të vatrave të furrave, të prodhuara nga shkrirja e bakrit
  - Zgjyra nga përpunimi i metaleve të çmuara, për rafinim të mëtejshëm
  - Zgjyra kallaji me përmbajtje tantaliumi me më pak se 0.5% kallaj
- B1110 Grupe elektrike dhe elektronike:
- Grupe elektronike që konsistojnë vetëm në metale ose aliazhe
  - Mbetje grupesh elektrike dhe elektronike ose skrape (përfshi pllakat me qarqe të stampuara), që nuk përmbajnë komponentë, të tillë si: akumulatorë dhe bateri, çelësa elektrike prej merkuri, qelq prej tubave me rreze katodike dhe qelqe të tjera aktivë, si edhe kondensatorë me PCB ose mbetje të rrezikshme
  - Grupe elektrike dhe elektronike (përfshirë pllakat me qarqe të stampuara, komponentët elektronikë dhe telat) të destinuar për ripërdorim të drejtpërdrejtë, dhe jo për riciklim apo eliminim përfundimtar
- B1115 Mbetje kabllosh prej metali të veshura apo të izoluara me plastikë, që nuk përmbajnë mbetje të rrezikshme
- B1120 Katalizatorë të përdorur, përjashtuar ato të lëngshëm, që përmbajnë ndonjë prej të mëposhtmeve:

Metalet tranzitore, përjashtuar katalizatorët mbeturinë (katalizatorë të përdorur, katalizatorë të lëngshëm të përdorur ose katalizatorë të tjerë me mbetje të rrezikshme)	Skandium Vanadium Mangan Kobalt Bakër Itrium Niobium Hafnium Tungsten	Titanium Krom Hekur Nikel Zink Zirkon Molibden Tantalium Renyum
--	---	---

Lantanidet (metale të rralla të tokës):	Lantanum Praseodimium Samarium Gadolinim Disprodium Erbium Iterbium	Cerium Neodi Europium Terbium Holmium Tulium Lutetium
---	---	---

- B1130 Katalizatorë të përdorur me përmbajtje metalesh të çmuar, të pastruar pas përdorimit
- B1140 Mbetje me përmbajtje metalesh të çmuar, në trajtë të ngurtë që përmbajnë gjurmë të cianideve inorganikë
- B1150 Mbetje të metaleve të çmuara dhe aliazheve (ar, argjend, grupi i platinit, por jo merkur), në trajtë të copëtuar (të shpërbërë), trajtë jo të lëngët me një paketim dhe etiketim të përshtatshëm
- B1160 Hiri i metaleve të çmuara që rezultojnë nga djegia e pllakat me qarqe të stampuara
- B1170 Hiri i metaleve të çmuara që rezultojnë nga djegia e filmave fotografikë
- B1180 Mbetje të filmave fotografikë që përmbajnë halide të argjendit dhe argjend metalik
- B1190 Mbetje të letrës fotografike që përmbajnë halide të argjendit dhe argjend metalik
- B1200 Zgjyrë e granular që rezulton nga prodhimi i hekurit dhe çelikut
- B1210 Zgjyrë që rezulton nga prodhimi i hekurit dhe çelikut, përfshirë edhe zgjyrën si burim i TiO<sub>2</sub> dhe vanadiumit
- B1220 Zgjyrë që rezulton nga prodhimi i zinkut, kimikisht të stabilizuar, që ka përmbajtje të lartë hekuri (mbi 20%) dhe e përpunuar në përputhje me specifikimet industriale (p.sh. DIN 4301) kryesisht për ndërtime
- B1230 Ashkla të frezimit/laminimit nga prodhimi i hekurit dhe çelikut
- B1240 Ashkla të frezimit/laminimit prej oksid bakri
- B1250 Mbetje nga automjetet në fund të jetës, që nuk përmbajnë as lëngje, as përbërës të tjerë të rrezikshëm

**B2 Mbetje që përmbajnë kryesisht përbërës inorganikë, të cilët mund të përmbajnë metale dhe materiale organike**

- B2010 Mbetje në trajtë jo të shpërbërë nga operacionet në miniera:
- Mbetje të grafitit natyral
  - Mbetje rreshpe, të prera, të sharruara ose jo
  - Mbetje të mikës
  - Mbetje prej leucitit, nefelinës dhe sienit nefelinës
  - Mbetje feldspari
  - Mbetje fluorspari
  - Mbetje të anhidritit të silicit në formë të ngurtë, përjashtuar ato të përdorura në operacionet e fonderisë

- B2020 Mbetje të qelqit në trajtë jo të shpërbërë:  
 - Qelq i thyer dhe mbetje të tjera prej skrapit qelqi, për rishkrirje, me përjashtim të qelqit të tubave me rreze katodike dhe qelqeve të tjera aktive
- B2030 Mbetje të qeramikes në formë jo të shpërbërë:  
 - Mbetje dhe skrap cermeti (kompozitë qeramiko-metalesh)  
 - Fibra me bazë qeramike, që nuk janë specifikuar apo përfshirë diku tjetër
- B2040 Mbetje të tjera që përmbajnë kryesisht përbërës inorganikë:  
 - Sulfat kaliumi pjesërisht i rafinuar, i prodhuar nga desulfurizimi i gazit të oxhaqeve (FGD)  
 - Mbetje të elementeve prej gipsi ose plastike që rezultojnë nga shembja (shkatërrimi) e ndërtesave  
 - Zgjyrë prej prodhimit të bakrit, e stabilizuar kimikisht, me përmbajtje të lartë hekuri (mbi 20%) dhe e përpunuar në bazë të specifikimeve industriale (p.sh. DIN 4301 dhe DIN 8201) që përdoret kryesisht në ndërtim dhe si abrasiv  
 - Sulfur në trajtë të ngurtë  
 - Gur gëlqeror që rezulton nga prodhimi i cianamidit të kaliumit (që ka  $\text{pH} < 9$ )  
 - Klorure të sodës, potasiumit dhe kaliumit  
 - Karborundum (karbid silikoni)  
 - Beton i thyer  
 - Litium-tantalum dhe litium-niobium me përmbajtje të skrapeve të qelqit
- B2050 Hi nga termocentralet me djegie qymyri, që nuk përmbajnë mbetje të rrezikshme
- B2060 Karbon aktiv i shuar që nuk përmbajnë mbetje të rrezikshme
- B2070 Llum nga floruri i kaliumit
- B2080 Mbetje gipsi që rezultojnë nga proceset e industrisë kimike, që nuk përmbajnë mbetje të rrezikshme
- B2090 Mbetje prej tufave anodike nga prodhimi i çelikut ose aluminit të përbëra nga qymyri i naftës ose bitum dhe të pastruar sipas specifikimeve të industrisë (përjashtuar mbetjet prej tufave anodike prej elektrolizave me bazë klori dhe prej industrisë metalurgjike)
- B2100 Mbetje hidratësh të aluminit, mbetje të aluminës dhe teprica të prodhimit të aluminës, përjashtuar materiale të tilla që përdoren në proceset e pastrimit të gazrave, flokulimit apo filtrimit
- B2110 Teprica boksidi (“baltë e kuqe”) ( $\text{pH}$  i moderuar në  $< 11.5$ )
- B2120 Mbetje prej tretësirave acide ose bazike me  $\text{pH}$  më të madh se 2 dhe më të vogël se 11.5, të cilat nuk janë korrozive apo të rrezikshme
- B2130 Materiale bituminoze (mbetje asfalti) nga ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, që nuk përmbajnë tar (shih grupin përkatës në listën A A3200). Niveli i përqendrimit të benzolit (a) pirene nuk duhet të jetë 50mg/kg apo më shumë se kaq.

### **B3 Mbetje që përmbajnë kryesisht përbërës organikë, që mund të përmbajnë metale dhe materiale inorganike**

#### **B3010 Mbetje të ngurta plastike:**

Materialet e mëposhtme plastike ose materiale plastike të përziara, kur nuk janë të përziara me mbetje të tjera dhe janë përgatitur sipas një specifikimi:

- Skrape plastikash prej polimereve jo të halogjenuar dhe co-polimereve, që përfshijnë, por nuk kufizohen në sa më poshtë (nënkuptohet që skrape të tilla janë plotësisht të polimerizuara):

- etilen
- stiren
- polipropilen
- polietilen tereftalate
- akrilonitrile
- butadien
- poliacetale
- poliamide
- polibutilen tereftalate
- polikarbonate
- polietere
- sulfide polifenili
- polimere akreliku
- alkane C10-C13 (plastifikatorë)
- poliurethan (që nuk përmbajnë CFC)
- polisiloksane
- polimetil matakriolat
- alkool polivinil
- polivinil butiral
- polivinil acetat

- Mbetje të rezinave të trajtuara ose produkte të kondensimit, përfshirë të mëposhtmet:

- rezina formaldehidi i uresë
- rezina formaldehid fenol
- rezina formaldehid melamine
- rezina epoksi
- rezina alkid
- poliamide

- Mbetjet e polimereve të fluoruara si më poshtë (përfshirë mbetjet që rezultojnë pas konsumit. Mbetjet nuk duhen përzier. Duhet konsideruar edhe problemet që dalin nga djegia e hapur):

- përfluoroetilen/propilen (FEP)
- përfluoroalkoksi alkanë
- tetrafluoretilenë/për fluorovinil eter (PFA)
- tetrafluoretilenë/për metilvinileter (MFA)
- polivinilfluorid (PVF)
- polivinilidenefluoride (PVDF)

#### **B3020 Mbetje të letrës, kartonit dhe produkteve të letrës**

Materialet e mëposhtme, kur nuk janë të përziara me mbetje të rrezikshme:

Mbetje dhe skrape të letrës ose kartonit prej:

- letre ose kartoni të pazbardhur ose prej letre apo kartoni të valëzuar

- letre ose kartoni të llojeve të tjera të përgatitura kryesisht prej pulpe kimike të zbardhur, jo të ngjyrosur në masë
- letre ose kartoni përgatitur kryesisht prej pulpe mekanike (gazeta dhe të tjera printime të ngjashme)
- të tjera që përfshijnë, por nuk kufizohen në: 1) karton të laminuar 2) skrape të pandara

### B3030 Mbetje tekstile

Materialet e mëposhtme, kur nuk janë të përziera me mbetje të tjera dhe janë përgatitur sipas një specifikë:

- mbetje mëndafshi (përfshirë kukulet e papërshtatshme për mbështjellje, mbetje të fijeve të leshit dhe gjysmëprodukte ose produkte tekstile të rikthyera)
  - jo të krehura
  - të tjera
- mbetje të leshit apo qime/flokë të holla ose të trasha të kafshëve, përfshirë mbetje të fijeve, por jo gjysmëprodukte ose produkte tekstile të rikthyera
  - pushi i leshit ose të qimeve/flokëve të holla të kafshëve
  - mbetje të tjera të leshit ose të qimeve/flokëve të holla të kafshëve
  - mbetje të qimeve/flokëve të papërpunuara të kafshëve
- mbetje pambuku (përfshirë mbetje fijesh dhe gjysmëprodukte ose produkte tekstile të rikthyera)
  - mbetje të fillit
  - gjysmëprodukte ose produkte tekstile të rikthyera
- të tjera
- fill me mbetje pushi, litar dhe mbetje liri
- fill me mbetje pushi, litar dhe mbetje (përfshirë mbetje fijesh dhe gjysmëprodukte ose produkte tekstile të rikthyera) prej këрпи të vërtetë (*Cannabis sativa L.*)
- fill me mbetje pushi, litar dhe mbetje (përfshirë mbetje fijesh dhe gjysmëprodukte ose produkte tekstile të rikthyera) prej jute dhe fibrave bast tekstile (përfshirë lirin, ramien, kërpën)
- fill me mbetje pushi dhe mbetje (përfshirë mbetje fijesh dhe gjysmëprodukte ose produkte tekstile të rikthyera) të kërpit sisal dhe fibra të tjera tekstile të tipit t[ Agave
- fill me mbetje pushi, push/fije dhe mbetje (përfshirë mbetje nga fijen dhe gjysmëprodukte ose produkte tekstile të rikthyera) prej arrës së kokosit (përfshirë fijen dhe gjysmë-produkte ose produkte tekstile të rikthyera) prej arrës së kokosit
- litar, push/fije dhe mbetje (përfshirë mbetje nga fijen dhe gjysmëprodukte ose produkte tekstile të rikthyera) prej abakje (këрпи Manila ose *Musa textilis Nee*)
- fill me mbetje pushi, litar, push/fije dhe mbetje (përfshirë mbetje nga fijen dhe gjysmëprodukte ose produkte tekstile të rikthyera) prej ramies dhe fibra të tjera tekstile vegjetale, të paspecifikuara ose të përfshira diku tjetër
- mbetje (përfshirë push/fije dhe mbetje nga fijen dhe gjysmëprodukte ose produkte tekstile të rikthyera) prej fibrave të bëra nga njeriu:
  - fibrave sintetike
  - fibrave artificiale
- veshje të përdorura ose artikuj të tjerë tekstilë të përdorur
- rreca të përdorura, mbetje spangoje, litarë dhe kablllo dhe artikuj të përdorur prej spangoje, litari ose kabllloje prej materialesh tekstile
  - të ndara

- të tjera.

B3035 Mbetje tekstile nga tapetet dhe mbulesat e dyshemesë

B3040 Mbetje gome

Materialet e mëposhtme, kur nuk janë të përziera me mbetje të tjera:

- mbetje dhe skrape prej gome të fortë (p.sh. eboniti)

- mbetje të tjera gome (përrjashtuara ato që janë të specifikuara diku tjetër)

Material tape i patrajtuar dhe mbetje druri:

- mbetje druri dhe skrap, në këmbë ose jo, briketa, peleta apo forma të tjera të ngjashme

- mbetje tape: tapë e shtypur, e granular ose e grirë

B3060 Mbetje (joinfektive) të industrisë agro-ushqimore:

- precipitati i verës

- mbetje vegjetale të thara dhe të sterilizuara, mbetje dhe nënprodukte, në formë peletash ose jo, të një tipi të përdorur për ushqyerjen e kafshëve, të cilat nuk përfshihen diku tjetër

- mbetje prej trajtimit të substancave të dhjamura/yndyrore ose dyllë me origjinë shtazore apo bimore

- mbetje prej palcës së kockave ose brirëve, të papunuara, të cilave u është hequr yndyra, që vetëm janë përgatitur (por që nuk janë prerë me forma), të trajtuara me acid ose të de-xhelatinosura

- mbeturina peshku

- mbeturina nga lëvozhga e kakaos, lëkurë apo mbetje të tjera prej kakaos

- mbetje të tjera prej industrisë agro-ushqimore, përjashtuar nënproduktet që plotësojnë kërkesat dhe standardet ndërkombëtare për konsum prej njeriut dhe kafshëve

B3065 Mbetje dhjamrash/yndyrnash dhe vajrash me origjinë shtazore apo bimore (p.sh.vajra për skuqje), kur nuk përmbajnë mbetje të rrezikshme

B3070 Mbetjet e mëposhtme:

- mbetje prej flokëve të njeriut

- mbetje kashte

- micela e deaktivizuar e kërpudhave prej prodhimit të penicilinës për t'u përdorur si ushqim për kafshët

B3080 Mbetje të copave të prera të gomave dhe skrap gome

B3090 Lëkurë e qethur dhe mbetje të tjera lëkure apo lëkure kompozitë jo të përshtatshme për prodhimin e artikujve të lëkurës, përjashtuar llumra të lëkurëve, që nuk përmbajnë përbërje të kromit 6 valent dhe biocide

B3100 Pluhur lëkure, hir, llumra apo pluhur që nuk përmbajnë përbërje të kromit 6 valent ose biocide

B3110 Mbetje gëzofësh, peliçesh që nuk përmbajnë përbërje të kromit 6 valent ose biocide ose substanca infektuese

B3120 Mbetje që konsistojnë në ngjyruetit e ushqimeve

B3130 Mbetje eteresh polimere dhe mbetje të etereve monomere jo të rrezikshme që nuk mund të formojnë perokside

B3140 Mbetje të gomave pneumatike

**B4 Mbetje që mund të përmbajnë edhe përbërës organikë edhe përbërës inorganikë**

B4010 Mbetje që konsistojnë kryesisht në bojëra ngjyruese me bazë uji/lateksi, bojëra dhe vernikë të ngurtësuar, që nuk përmbajnë tretës organikë, metale të rënda ose biocide në një masë të tillë që t'i bëjë ata të rrezikshëm

B4020 Mbetje prej prodhimit, formulimit dhe përdorimit të rezinave, latekseve, plastifikatorëve, ngjitësve/adezivëve, që nuk përmbajnë solventë dhe ndotës të tjerë atë masë sa që të paraqesin karakteristikat e mbetjeve të rrezikshme, p.sh. me bazë uji apo zamke, me bazë niseshte kazeine, dextrin, eter celuloze, alcohole polivinike

B4030 Kamera të përdorura njëpërdorimshe, me bateri, që nuk përmbajnë mbetje të rrezikshme



**ANEKSI 3**  
**DOKUMENTI I NJOFTIMIT PËR TRANSFERTA/LËVIZJE NDËRKUFITARE TË MBETJEVE**

<p>1. Rregjistrimi i eksportuesit – njoftuesit          Numri:          Emri:          Adresa:          Personi i kontaktit:          Tel: <span style="float: right;">Fax:</span>          E-mail:</p>	<p>3. Njoftimi          Nr.          Njoftim për:          A.(i) Transfertë të vetme: <input type="checkbox"/> (ii) transferata të shumëfishta: <input type="checkbox"/>          B. (i) Asgjësim (1): <input type="checkbox"/> (ii) Rikuperim: <input type="checkbox"/>          C. Impianti i rikuperimit i miratuar paraprakisht:          (2;3) <span style="margin-left: 100px;">Po <input type="checkbox"/></span> <span style="margin-left: 100px;">Jo <input type="checkbox"/></span></p>
<p>2. Importuesi – marrësi në dorëzim          Numri i regjistrimit:          Emri:          Adresa:          Personi i kontaktit:          Tel: <span style="float: right;">Fax:</span>          E-mail:</p>	<p>4. Numri total i transfertave të synuara:</p>
<p>8. Transportuesit e pritshëm          Numri i regjistrimit:          Emri (7):          Adresa:          Personi i kontaktit:          Tel: <span style="float: right;">Fax:</span>          E-mail:          Mjeti i transportit (5):</p>	<p>5. Sasia totale e synuar (4):          Ton (Mg):          m<sup>3</sup>:          6. Periudha e kohës së synuar për transfertën/at (4):          Nisja e parë: <span style="margin-left: 100px;">Nisja e fundit:</span>          7. Lloji/et e paketimit/ambalazhimit (5):          Kërkesa të veçanta për kujdesje gjatë transferimit:          (6): <span style="margin-left: 20px;">Po: <input type="checkbox"/></span> <span style="margin-left: 100px;">Jo: <input type="checkbox"/></span></p>
<p>9. Gjeneruesi/t e mbetjeve - prodhuesi/t (1;7;8)          Numri i regjistrimit:          Emri:          Adresa:          Personi i kontaktit:          Tel: <span style="float: right;">Fax:</span>          E-mail:          Sheshi dhe procesi i gjenerimit (6):</p>	<p>11. Operacionet e rikuperimit (2)          D-code / R-code          (5) :          Teknologjia që përdoret          (6):          Arësytet për eksport          (1;6):</p>
<p>10. Impiant asgjësimi(2): <input type="checkbox"/>          apo impiant rikuperimi (2): <input type="checkbox"/>          Numri i regjistrimit:          Emri:          Adresa:          Personi i kontaktit:          Tel: <span style="float: right;">Fax:</span>          E-mail:          Sheshi aktual i asgjësimit/ rikuperimit:</p>	<p>12. Emri dhe përbërja e mbetjes (6):</p>
<p>15. (a) Vendet/shtetet e interesuara, (b) Nr. i kodit të autoritetit kompetent aty ku është e aplikueshme, (c) Pikat e veçanta të daljes apo të hyrjes (kufijtë apo portet ku kalon)</p>	<p>13. Karakteristika fizike (5):</p>
<p>Shteti eksportues – nga ku bëhet dalja</p>	<p>14. Identifikimi i mbetjes (plotësoni kodet e duhura)          (i) Aneksi VIII (ose IX nëse ka kuptim) i Bazelit          (ii) Kodi i OECD (nëse i ndryshëm nga (i)):          (iii) Lista e mbetjeve e Komisionit European:          (iv) Kodi nacional në vendin e eksportit:          (v) Kodi nacional në vendin e importit:          (vi) Të tjera (specifikoni):          (vii) Kodi Y:          (viii) Kodi H (5):          (ix) Klasa e BE-së (5):          (x) Numri i BE-së:          (xi) Emri i transfertës së BE-së:          (xii) Kodi/et e doganave (HS):</p>
<p>Shteti/et e tranzitit (të hyrjes dhe daljes)</p>	<p>15. (a) Vendet/shtetet e interesuara, (b) Nr. i kodit të autoritetit kompetent aty ku është e aplikueshme, (c) Pikat e veçanta të daljes apo të hyrjes (kufijtë apo portet ku kalon)</p>
<p>Shteti importues – destinacioni</p>	<p>Shteti importues – destinacioni</p>

(a)							
(b)							
(c)							
16. Zyrat e doganave të hyrjes dhe/ose daljes dhe/ose të eksportit (Komuniteti Europian):							
Hyrja:		Dalja:				Eksporti:	
